



**Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Kualifikimeve  
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

## **STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL**

### **“KËRKIM, SHPIM DHE SHFRYTËZIM PËR NAFTË, GAZ DHE UJË”**

**Niveli IV në KSHK<sup>1</sup>, referuar nivelit IV të KEK<sup>2</sup>**

**X-IV-25**

**Tiranë, 2025**

---

<sup>1</sup> Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

<sup>2</sup> Korniza Evropiane e Kualifikimeve

## **Përmbajtja**

Emërtimi i kualifikimit .....	4
Kodi.....	4
Kohëzgjatja .....	4
Niveli .....	4
Qëllimi:.....	4
Kriteret e përgjithshme të pranimit: .....	4
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit: .....	4
Ofruesit .....	4
Data e validimit .....	4
Data e miratimit .....	5
Variantet e mëparshme.....	5
<b>STRUKTURA E KUALIFIKIMIT.....</b>	<b>5</b>
<b>KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME .....</b>	<b>5</b>
<b>NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL .....</b>	<b>6</b>
<b>NjN-21-IV-0389-25 Planifikimi, organizimi dhe koordinimi i punës në kërkim, shpim dhe shfrytëzim për naftë, gaz dhe ujë.....</b>	<b>6</b>
Rezultatet e të nxënit në njohuri .....	6
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale .....	6
Kriteret e vlerësimit .....	6
<b>NjN-21-IV-0390-25 Mbikëqyrja e proceseve teknologjike (shpimit dhe shfrytëzimit të puseve të naftës, gazit dhe ujit).....</b>	<b>7</b>
Rezultatet e të nxënit në njohuri .....	7
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale .....	8
Kriteret e vlerësimit .....	8
<b>NjN-21-IV-0391-25 Mbikëqyrja e cilësisë së punimeve.....</b>	<b>10</b>
Rezultatet e të nxënit në njohuri .....	10
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale .....	10
Kriteret e vlerësimit .....	10
<b>NjN-23-IV-0005-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere .....</b>	<b>11</b>
Rezultatet e të nxënit në njohuri .....	11
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale .....	11

Kriteret e vlerësimit .....	11
<b>NjN-22-IV-0006-24 Komunikimi dhe etika profesionale.....</b>	<b>12</b>
Rezultatet e të nxënit në njohuri .....	12
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale .....	13
Kriteret e vlerësimit .....	13
<b>NjN-21-IV-0392-25 Mbikëqyrja e rregullave të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit në kërkim, shpim dhe shfrytëzim të puseve të naftës , gazit dhe ujit .....</b>	<b>13</b>
Rezultatet e të nxënit në njohuri .....	13
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale .....	14
Kriteret e vlerësimit .....	14
Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse: .....	15
Modalitetet e vlerësimit.....	15
Informacion shtesë .....	16
SHËNIM.....	16

<b>Emërtimi i kualifikimit</b>	<b>KËRKIM, SHPIM DHE SHFRYTËZIM PËR NAFTË, GAZ DHE UJË</b>			<b>Kodi</b>
<b>Kohëzgjatja</b>	<b>1100-1500 orë nocionale</b>	<b>Niveli</b>	<b>Niveli IV KSHK, referuar nivelit IV të KEK</b>	<b>X-IV-25</b>
<b>Qëllimi:</b>	Qëllimi i kualifikimit profesional <b>“Kërkim, shpim dhe shfrytëzim për naftë, gaz dhe ujë” niveli IV në KSHK</b> , referuar nivelit IV të KEK, është të përgatisë specialistë të nivelit teknik/menaxher të mesëm në fushën e kërkimit, shpimit dhe shfrytëzimit të naftës, gazit dhe ujit dhe t’i bëjë të aftë për t’u punësuar në veprimtaritë e menaxhimit të një reparti, sektori, linje prodhimi, brigade, ose njësie të ngjashme të kësaj fushe, apo për krijimin dhe menaxhimin e një biznesi privat, person fizik ose juridik si dhe të zhvillojë personalitetin e individëve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon.			
<b>Kriteret e përgjithshme të pranimit:</b>	Në institucionet e arsimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional <b>“Kërkim, shpim dhe shfrytëzim për naftë, gaz dhe ujë” të nivelit IV në KSHK</b> , referuar nivelit IV të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që: <ul style="list-style-type: none"> <li>- kanë mbaruar arsimin profesional në një nga kualifikimet profesionale të nivelit III të KSHK, referuar nivelit III të KEK, të drejtimit <b>“Kërkim, shpim dhe shfrytëzim për naftë, gaz dhe ujë”</b>;</li> <li>- janë në kushte shëndetësore, që e lejojnë kryerjen e detyrës për përballimin e kërkesave të këtij niveli të arsimit profesional;</li> <li>- pranohen edhe individë që kanë aftësi ndryshe, për të cilët ofruesi i kualifikimit krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me aftësitë që shfaqin.</li> </ul>			
<b>Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:</b>	Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional <b>“Kërkim, shpim dhe shfrytëzim për naftë, gaz dhe ujë”, niveli IV në KSHK</b> , referuar nivelit IV të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Supplementin përkatës të këtij niveli që përkon me nivelin profesional teknik/menaxher i mesëm në këtë fushë profesionale, të njohur në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky kualifikim i jep individit mundësinë që t’i drejtohet tregut të punës për punësim në ndërmarrje të ndryshme private/shtetërore që ushtrojnë aktivitet në fushën e kërkimit, shpimit dhe shfrytëzimit të naftës, gazit dhe ujit dhe gjithë sektorët e tyre. Gjithashtu, individi mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e kërkimit, shpimit dhe shfrytëzimit të naftës, gazit dhe ujit. Me përfundimin e këtij niveli, individi ka mundësi për të fituar të drejtën e Diplomës së <b>“Maturës Shtetërore Profesionale”</b> , si dhe pajiset me Certifikatën e teknikut/menaxherit të mesëm në këtë fushë profesionale. Me përfundimin e këtij niveli, individi ka mundësi për vazhdimin e arsimit në nivelin pas të mesëm ose në nivelin e studimeve universitare.			
<b>Ofruesit</b>	Ky kualifikim duhet të ofrohet nga ofrues të akredituar në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.			
<b>Data e validimit</b>	Dhjetor 2025			

<b>Data e miratimit</b>	<i>(kur të miratohet)</i>
<b>Variantet e mëparshme</b>	<b>X-IV-18</b>

## **STRUKTURA E KUALIFIKIMIT**

Në përfundim të kualifikimit profesional **“Kërkim, shpim dhe shfrytëzim për naftë, gaz dhe ujë”**, niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, individi duhet të zotërojë njohuritë, shprehitë profesionale dhe kompetencat e përgjithshme të ndara sipas njësive të të nxënit të mëposhtme:

### **KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME**

*Rezultatet e të nxënit të kompetencave të përgjithshme janë të vlefshme për të gjitha njësitë e të nxënit.*

1. Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme kulturore, sociale, ligjore, organizative e tekniko-profesionale;
2. Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional dhe ti shpërndajë ato, në dobi të kolegëve e punonjësve;
3. Të nxisë potencialin e tij/saj të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
4. Të ndërmarrë apo hedhë vazhdimisht ide te reja, duke hartuar projekte të reja, struktura të reja organizative, të cilat sjellin përmirësimin e strukturave ekzistuese;
5. Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
6. Të respektojë rregullat dhe parimet e gjithëpërfshirës;
7. Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij/saj;
8. Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij/saj, të jete i/e matur dhe i/e sjellshëm me eprorët, vartësit, partnerët etj.;
9. Të organizojë drejt procesin e të nxënit të tij/saj dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
10. Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të caktuara;
11. Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë aftësitë e tij/saj, nisur nga kritere të drejta, si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij/saj;
12. Të jetë i/e hapur dhe të veprojë si një ndërlidhës midis njësisë së tij/saj të shërbimit dhe njësive të tjera brenda institucionit apo ndërmjet institucionit dhe të tretëve jashtë tij/saj, si furnitorët, klientët, partneret, etj., duke ndihmuar në realizimin e qëllimeve të njësisë së shërbimit;
13. Të demonstrojë aftësi për të përmbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar;
14. Të marrë nisma për të bashkëpunuar me të tjerët, qofshin individë, grupe apo institucione;
15. Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtari, aktivitete social-kulturore dhe komunitet;

16. Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për qenë pjesëmarrës pro aktiv në grup;
17. Të demonstrojë përgjegjshmëri ndaj mjedisit dhe të mirave publike;
18. Të pranojë dhe të promovojë risitë dhe ndryshimet;
19. Të demonstrojë marrjen e nismave për të zhvilluar dhe zbatuar një ide;
20. Të demonstrojë zotësi për të nxënë nga dështimet dhe për të këmbëngulur drejt arritjes së synimeve të tij/saj;
21. Të aplikojë mënyra konstruktive të përgjigjeve ndaj kritikave.

## **NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:**

Standardet e kualifikimit hartohen në bazë të rezultateve të të nxënit (kompetenca të përgjithshme, njohuri dhe shprehi profesionale).

### **NjN-21-IV-0389-25 Planifikimi, organizimi dhe koordinimi i punës në kërkim, shpim dhe shfrytëzim për naftë, gaz dhe ujë**

#### **Rezultatet e të nxënit në njohuri**

1. Të shpjegojë strukturën organizative të një ndërmarrjeje të shpim - shfrytëzimit;
2. Të argumentojë rëndësinë e zbatimit të legjislacionit në fushën e hidrokarbureve;
3. Të shpjegojë mënyrën dhe rëndësinë e organizimit dhe shpërndarjes së detyrave;
4. Të shpjegojë rëndësinë e vendosjes së përparësive të proceseve;
5. Të shpjegojë mënyrën e përdorimit të materialeve, mjeteve, pajisjeve dhe makinerive të punës;
6. Të argumentojë rëndësinë e bashkëpunimit mes specialistëve, sipas radhës së kryerjes së proceseve të ndryshme teknologjike;
7. Të shpjegojë mënyrën e menaxhimit të burimeve njerëzore, sipas kualifikimeve të tyre;
8. Të shpjegojë rëndësinë e vendit të punës dhe organizimin e saj në mënyrë funksionale;
9. Të shpjegojë problemet që hasen në mosfunksionimin e mjeteve, makinerive, pajisjeve të punës dhe masat që merren për eliminimin e tyre;
10. Të argumentojë rëndësinë e mbikëqyrjes së zbatimit të radhës së punës për pastrimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve, instrumenteve, pajisjeve dhe vendit të punës;
11. Të shpjegojë mënyrën e regjistrimit, dokumentimit, raportimit për gjithë proceset e punës;
12. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të teknologjisë digjitale në proceset e punës.

#### **Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale**

1. Të kryejë organizimin dhe planifikimin e punës sipas proceseve;
2. Të menaxhojë mjetet, pajisjet dhe makineritë e punës të nevojshme;
3. Të menaxhojë burimet njerëzore të nevojshme;
4. Të kryejë dokumentimin dhe raportimin e proceseve të punës.

#### **Kriteret e vlerësimit**

- Merr punën në dorëzim në bazë të raportit ditorë dhe procedurës së punës;
- Planifikon proceset e punës, sipas udhëzimeve në raportin ditorë dhe urdhrave verbal dhe zyrtare nga eprorët;
- Planifikon radhën dhe kohën e punës, sipas përparësive dhe proceseve;
- Planifikon mjetet, makineritë, materialet dhe pajisjet e punës, sipas proceseve teknologjike;
- Siguron materialet, mjetet, pajisjet dhe makineritë e punës, sipas planifikimit të procesit;
- Planifikon burimet njerëzore të nevojshme, sipas detyrave përkatëse;
- Përzgjedh burimet njerëzore sipas përvojës dhe kualifikimeve;
- Kontrollon mjetet, pajisjet dhe makineritë e punës për funksionimin normal të tyre;
- Merr masa në rast të mosfunksionimit të mjeteve, makinerive dhe pajisjeve të punës duke manovruar për të minimizuar avaritë dhe raportuar eprorët;
- Koordinon organizimin e vendit të punës në mënyrë ergonomike për çdo sektor;
- Ndan detyrat në ekip, sipas specifikimeve të punës;
- Koordinon bashkëpunimin mes specialistëve në kantier dhe palëve të treta, sipas detyrave përkatëse;
- Mbikëqyr pastrimin dhe sistemimin e vendit të punës, sipas procedurës;
- Mbikëqyr pastrimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve, makinerive dhe pajisjeve të punës pas çdo procesi;
- Përdor sistematikisht mjetet, instrumentet, aparatet dhe teknologjitë digjitale në proceset e punës;
- Dokumenton sistematikisht proceset e punës, sipas formatit standard;
- Jep rekomandime tek kolegu për ecurinë e punës në vazhdimësi;
- Raporton tek eprorët dhe kolegët për ecurinë e punës, sipas çdo sektori.

### **NjN-21-IV-0390-25 Mbikëqyrja e proceseve teknologjike (shpimit dhe shfrytëzimit të puseve të naftës, gazit dhe ujit)**

#### **Rezultatet e të nxënit në njohuri**

1. Të shpjegojë etapat e shpimit dhe shfrytëzimit të puseve të naftës, gazit dhe ujit;
2. Të shpjegojë elementet e konstruksioneve të puseve;
3. Të interpretojë teknikat e mbikëqyrjes së ecurisë së shpimit të pusit;
4. Të klasifikojë pajisjet dhe instrumentet për mbikëqyrjen e shpimit;
5. Të shpjegojë teknikat e mbikëqyrjes së uljes dhe çimentimit të kolonave të rrethimit;
6. Të shpjegojë teknikat e mbikëqyrjes së parametrave të shpimit (presioni, temperatura, shpejtësia e shpimit, etj.) dhe rëndësinë e tyre;
7. Të shpjegojë teknikat e mbikëqyrjes së procesit të perforimit, larjes dhe përvetësimit të pusit;
8. Të shpjegojë teknikat e mbikëqyrjes, analizës dhe raportimit për shtresat produktive;
9. Të argumentojë rëndësinë e rregullave dhe procedurat për dorëzimin e puseve për shfrytëzim.
10. Të përshkruajë rëndësinë e mbikëqyrjes së përdorimit të njësisve dhe pajisjeve matëse të prodhimit sipas funksionimit të tyre;

11. Të argumentojë rëndësinë e përdorimit të pajisjeve nëntokësore dhe sipërfaqësore, funksionimin dhe përdorimin e tyre;
12. Të shpjegojë rëndësinë e mbikëqyrjes së mënyrave, parametrave të pompimit dhe të presionit të lejuar gjatë procesit;
13. Të identifikojë defektet dhe anomalitë gjatë pompimit dhe masat për eliminimin e tyre;
14. Të theksojë rëndësinë e mbikëqyrjes së punimeve të remontit nëntokësor;
15. Të theksojë rëndësinë e mbikëqyrjes së veprimeve të kryera gjatë shfrytëzimit të puseve të naftës;
16. Të argumentojë mbi recepturën e agjentit për injektim dhe rëndësinë e mbikëqyrjes së përgatitjes së tij;
17. Të shpjegojë ecurinë e procesit të shfrytëzimit të puseve të naftës me metodat e dyta në vendburim;
18. Të shpjegojë rëndësinë e mbikëqyrjes së procesit të nxjerrjes së gazit dhe pajisjet përkatëse;
19. Të përshkruajë teknikat e mbikëqyrjes së prodhimit aktual të puseve të gazit;
20. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të teknikave të matjes së presionit dhe kontrollit të rrjedhës së gazit;
21. Të përshkruajë teknikat e mbikëqyrjes së pastrimit (seperimit) të gazit nga fluidet shoqëruese;
22. Të përshkruajë teknikat e mbikëqyrjes së parametrave të kompresorëve dhe tubacioneve;
23. Të përshkruajë teknikat e mbikëqyrjes së parametrave të magjistralit (presioni, volumi, temperatura, etj.);
24. Të parashikojë llojet e problematikave dhe anomalive në pusët, linjat dhe magjistralin e gazit;
25. Të shpjegojë mënyrën e menaxhimit të anomalive/problematikave;
26. Të theksojë rëndësinë e ndërprerjes së procesit të shfrytëzimit/transportit në raste anomalish;
27. Të theksojë rëndësinë e raportimit për avaritë/anomalitë në pusët/linjat/magjistralet e gazit.
28. Të shpjegojë rëndësinë e procesit të ardhjes së ujit bashkëshoqërues të vendburimeve hidrokarbure;
29. Të shpjegojë teknikat e mbikëqyrjes së matjes së vëllimit, përbërjes kimike të ujit shoqërues të naftës/gazit;
30. Të shpjegojë teknikat e mbikëqyrjes së procesit të ndarjes së ujit në seperatorë;
31. Të shpjegojë teknikat e mbikëqyrjes së procesit të transportit të ujit;
32. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të procesit të injektimit dhe parametrave të ujit në shtresë.

### **Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale**

1. Të mbikëqyrë procesin e shpimit dhe shfrytëzimit të puseve të naftës;
2. Të mbikëqyrë procesin e shpimit dhe shfrytëzimit të puseve të gazit;
3. Të mbikëqyrë procesin e shpimit dhe shfrytëzimit të puseve të ujit.

### **Kriteret e vlerësimit**

- Përgatit vendin e punës për shpimin e pusit në mënyrë ergonomike;

- Monitoron piketimin (shënjimimin) me saktësi të vendit të shpimit të pusit sipas udhëzimeve të ekipit të kërkimit;
- Përzgjedh makineritë e duhura për procesin e shpimit;
- Zbaton/mbikëqyr procedurat e shpimit të pusit;
- Mbikëqyr ecurinë e shpimit të pusit sipas konstruksionit;
- Kryen kontrollin dhe matje gjatë shpimit të pusit sipas procedurës;
- Mbikëqyr uljen dhe çimentimin e kolonave të rrethimit, sipas konstruksionit dhe standardit;
- Kryen kontrollin e parametrave të shpimit si densiteti i lëngut larës, devijimi i pusit, etj., duke përdorur instrumentet përkatëse;
- Kryen kontrollin e performimit dhe përvetësimit të pusit sipas teknikës përkatëse;
- Kryen kontrollin e ecurisë së aktivizimit të shtresës produktive sipas projektit;
- Kryen raportime periodike për parametrat e ardhjes së fluideve të shtresës produktive, sipas formateve të caktuara;
- Dorëzon pusin për shfrytëzim sipas procedurës;
- Mbikëqyr/kryen matjet sasiore dhe cilësore të puseve të naftës sipas procesit;
- Mbikëqyr ecurinë e punës të pajisjeve në puset e naftës si rripat trapezoidal, reduktorit, kushinetave, vajit të burmave etj.;
- Mbikëqyr kontrollin e pompave të transportit, sipas procedurës;
- Mbikëqyr parametrat e pompave të transportit të naftës, sipas procesit të punës;
- Merr masa për parandalimin dhe eliminimin e anomalive dhe avarive të ndryshme;
- Mbikëqyr punimet e remontit nëntokësor, sipas procesit të punës;
- Mbikëqyr manovrat e kryera gjatë shfrytëzimit dhe ecurinë e prodhimit të puseve të naftës;
- Mbikëqyr përgatitjen e agjentit për injektim në përputhje me programin e punës për zbatimin e metodave të dyta;
- Përcakton recepturën e sasisë së holluesit për çdo pus, sipas specifikave të fluidit;
- Mbikëqyr injektimin e holluesit, sipas recepturës;
- Mbikëqyr ecurinë e procesit të shfrytëzimit të puseve të naftës me metodat e dyta në vendburim;
- Mbikëqyr/kryen matjet sasiore dhe cilësore të puseve të gazit, sipas procesit;
- Mbikëqyr ecurinë e punës së pajisjeve të puseve të gazit si saraçineska, valvola, kompresorëve, manometrave etj.;
- Mbikëqyr kontrollin e kompresorëve të transportit të gazit dhe parametrat e tyre;
- Mbikëqyr parametrat e magjstralit të transportit të gazit;
- Merr masa për parandalimin dhe eliminimin e anomalive, sipas procesit;
- Drejton punimet e remontit nëntokësor, sipas procesit;
- Mbikëqyr manovrat e kryera gjatë shfrytëzimit dhe ecurinë e prodhimit të puseve të gazit;
- Ndërpren shfrytëzimin e puseve të gazit në rast anomalish, sipas rregullores;
- Kryen raportime periodike për avaritë/anomalitë në puset/linjat/magjistralet e gazit;

- Mbikëqyr ecurinë e ardhjes së ujit bashkëshoqërues të vendburimeve hidrokarbure;
- Mbikëqyr matjen e vëllimit, përbërjes kimike të ujit shoqërues të naftës/gazit me mjetet dhe aparatet përkatëse;
- Mbikëqyr procesin e ndarjes së ujit në seperatorë;
- Mbikëqyr procesin e transportit të ujit;
- Mbikëqyr zbatimin e procesit të injektimit dhe parametrave të ujit në shtresë.

## **NjN-21-IV-0391-25 Mbikëqyrja e cilësisë së punimeve**

### **Rezultatet e të nxënit në njohuri**

1. Të shpjegojë mënyrat e mbikëqyrjes së treguesve teknikë gjatë shpimit të puseve në çdo fazë të tij;
2. Të shpjegojë rëndësinë e vlerësimit të llojeve të shkëmbinjve dhe karakteristikat e tyre gjatë shpimit të pusit nga sipërfaqja deri në thellësinë e projektuar;
3. Të shpjegojë rëndësinë e vlerësimit të llojeve të lëngut larës dhe karakteristikat e tij për çdo fazë shpimi;
4. Të shpjegojë rëndësinë e vlerësimit të funksioneve teknike të makinerive e pajisjeve në të gjithë padin e shpimit dhe sektorët e tij;
5. Të shpjegojë rëndësinë e vlerësimit të bazës materiale, sasinë dhe zërat e tyre për të realizuar shpimin e pusit sipas projektit;
6. Të shpjegojë rëndësinë e vlerësimit të treguesve teknik dhe kontrolleve të tyre gjatë shfrytëzimit të puseve të naftës dhe gazit;
7. Të argumentojë rëndësinë e vlerësimit të punimeve të remontit nëntokësor, llojet e tyre, programet e punës dhe teknikat e kontrollit të cilësisë;
8. Të argumentojë rëndësinë e vlerësimit të aplikimeve të metodave të dyta, llojet e tyre, teknikat e kontrollit të ecurisë dhe cilësisë së tyre;
9. Të argumentojë rëndësinë e vlerësimit të treguesve teknikë dhe kontrollit të tyre gjatë transportit, dekantimit, trajtimit të naftës dhe gazit.

### **Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale**

1. Të kontrollojë treguesit teknik gjatë shpimit dhe shfrytëzimit të puseve;
2. Të kontrollojë cilësinë e punimeve të remontit nëntokësor të puseve të naftës, gazit dhe ujit;
3. Të kontrollojë parametrat e përdorimit të metodave të dyta në pusët e naftës dhe gazit;
4. Të kontrollojë treguesit teknik gjatë trajtimit të naftës dhe gazit;

### **Kriteret e vlerësimit**

- Kontrollon periodikisht dhe me saktësi treguesit teknik gjatë ecurisë së shpimit të puseve të naftës dhe gazit;
- Kontrollon sistematikisht treguesit teknik gjatë shfrytëzimit të puseve të naftës, gazit dhe ujit;
- Kontrollon cilësinë e punimeve të remontit nëntokësor të puseve të naftës, gazit dhe ujit;
- Kontrollon parametrat për efektshmërinë e përdorimit të metodave të dyta në pusët e naftës dhe gazit;

- Kontrollon në mënyrë të vazhdueshme treguesit teknik gjatë trajtimit të naftës dhe gazit.

## **NjN-23-IV-0005-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere**

### **Rezultatet e të nxënit në njohuri**

1. Të shpjegojë një plan të thjeshtë biznesi sipas elementëve përkatës;
2. Të listojë llojet e dokumentacioneve financiare dhe ligjore;
3. Të shpjegojë parimet bazë të kodit të punës dhe legjislacionin bazë i fushës;
4. Të klasifikojë format dhe mënyrat e hartimit dhe arkivimit të dokumentacioneve;
5. Të shpjegojë mënyrën e llogaritjes së materialet dhe grafikun e kohës së kohës së punës;
6. Të shpjegojë rëndësinë e gjenerimit të të dhënave të faturave;
7. Të shpjegojë mënyrat e përgatitjes së një oferte;
8. Të shpjegojë mënyrat e informimit nga tregu për çmimin dhe cilësinë e mjeteve, materialeve, makinerive dhe pajisjeve të punës;
9. Të shpjegojë mënyrat e llogaritjes së kostove të mjeteve, materialeve, makinerive, pajisjeve të punës dhe shërbimeve të kryera;
10. Të klasifikojë mënyrat e blerjes së mjeteve, materialeve, makinerive dhe pajisjeve të punës;
11. Të shpjegojë mënyrat e llogaritjes së çmimeve përfundimtare për punimet/shërbimet e ofruara;
12. Të shpjegojë llojet e dokumenteve financiare për dorëzimin e punimeve/shërbimeve dhe mënyra e përgatitjes së tyre;
13. Të shpjegojë teknikat e marketingut;
14. Të shpjegojë rëndësinë e vetëvlerësimit;
15. Të shpjegojë rëndësinë e zhvillimit profesional;
16. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të teknologjive bashkëkohore për proceset e punës;
17. Të shpjegojë mënyrat e transmetimit në kohë tek bashkëpunëtorët të njohurive dhe aplikimin e teknikave të reja në punë;
18. Të argumentojë rëndësinë e vlerësimit të performancës së stafit;
19. Të analizojë mënyrat dhe rëndësinë e trajnimit të stafit të ri;
20. Të theksojë rëndësinë e përdorimit të literaturës bashkëkohore;
21. Të analizojë rëndësinë e ndjekjes së panairëve, konferencave, trajnimeve, kurseve dhe ekspozitave kombëtare dhe ndërkombëtare etj.

### **Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale**

1. Të zbatojë legjislacionin tatimor, kodin e punës në fuqi dhe legjislacionin në fushën e lidhur me aktivitetin që kryen;
2. Të kryejë llogaritje financiare për aktivitetin që kryen;
3. Të përgatisë oferta duke zbatuar teknikat e marketingut;
4. Të kryejë trajnime të vazhdueshme për rritjen profesionale.

### **Kriteret e vlerësimit**

- Harton një plan të thjeshtë biznesi sipas elementëve përkatës;
- Zbaton legjislacionin tatimor, kodin e punës në fuqi dhe legjislacionin në fushën e lidhur me aktivitetin që kryen;
- Plotëson saktë planet periodike të punës, në përputhje me detyrat;
- Dokumenton punën e kryer dhe urdhrat e punës sipas formateve të miratuara;
- Monitoron regjistrimin e të dhënave për faturat dhe ofertat e lëshuara klientëve, sipas procedurave;
- Përgatit raporte periodike të punës për aktivitetet e zbatuara sipas formatit;
- Merr vazhdimisht informacion nga tregu lidhur me çmimin dhe cilësinë e mjeteve, materialeve, makinerive dhe pajisjeve të punës;
- Kryen saktë llogaritjet të kostos së mjeteve, materialeve, makinerive, pajisjeve të punës dhe shërbimeve të kryera;
- Përgatit oferta për punimet/shërbimet që do të ofrojë, sipas nevojës;
- Kryen blerje të mjeteve, materialeve, makinerive dhe pajisjeve të punës, sipas nevojës;
- Llogarit saktë çmimin përfundimtar për punimet/shërbimet e ofruara;
- Plotëson procesverbalin/dokumentin e dorëzimit të punimeve/shërbimeve te klienti sipas procedurës;
- Zbaton teknika të marketingut për punimet/shërbimet që do të kryejë
- Gjeneron/plotëson të dhënat e faturave, sipas procedurës dhe formatit.
- Vlerëson veten për zhvillim e vazhduar profesional;
- Identifikon/planifikon nevojat për trajnim të vetes dhe të stafit;
- Trajnon në mënyrë specifike stafin e ri;
- Motivon dhe vlerëson vazhdimisht stafin;
- Informon/trajnon vazhdimisht bashkëpunëtorët për njohuritë dhe aplikimin e teknikave të reja;
- Mbështetet në metodat dhe literaturën bashkëkohore;
- Ndjek panaire, ekspozita dhe konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Merr pjesë në trajnime dhe kurse të ndryshme të fushës profesionale;

## **NjN-22-IV-0006-24 Komunikimi dhe etika profesionale**

### **Rezultatet e të nxënit në njohuri**

1. Të argumentojë rëndësinë e përzgjedhjes së metodave të informacionit për problemet dhe të rejat e ditës;
2. Të argumentojë rëndësinë e komunikimit dhe metodat e tij;
3. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të parimeve të punës në grup;
4. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të kodit të etikës;
5. Të vlerësojë metodat e zgjidhjes së problemeve dhe mendimit kritik;
6. Të argumentojë rëndësinë e bashkëpunimit me kolegët, eprorët, etj.;

7. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të TIK (*Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit*) në komunikimin me të tjerët;
8. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë profesionale;
9. Të shpjegojë rëndësinë e respektimit të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare, etj.

### **Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale**

1. Të zbatojë kodin e etikës dhe rregullat e hierarkisë profesionale në komunikim me eprorët, kolegët, vartësit dhe komunitetin;
2. Të mbikëqyrë zbatimin e teknikave të komunikimit me bashkëpunëtorët, kolegët dhe të tretët;
3. Të mbikëqyrë/zbatojë përdorimin e terminologjisë profesionale dhe teknologjisë së informacionit në komunikim gjatë proceseve të punës.

### **Kriteret e vlerësimit**

- Zbaton rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal, sipas kodit të etikës;
- Merr vazhdimisht informacione për detyrat dhe të rejat e ditës;
- Mbikëqyr/zbaton parimet e punës në grup;
- Mbikëqyr/zbaton rregullat e komunikimit me eprorët, kolegët, vartësit, klientin dhe komunitetin;
- Mbikëqyr/zbaton parimet e etikës profesionale;
- Merr/jep udhëzime duke përdorur terminologjinë profesionale, sipas rregullave të komunikimit me bashkëpunëtorë për realizimin e detyrës;
- Mbikëqyr/përdor teknologjitë bashkëkohore të informacionit dhe komunikimit me të tjerët;
- Zgjidh ankesat dhe mosmarrëveshjet me eprorët, kolegët, vartësit dhe komunitetin në kohën e duhur;
- Respekton të drejtat e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.

### **NjN-21-IV-0392-25 Mbikëqyrja e rregullave të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit në kërkim, shpim dhe shfrytëzim të puseve të naftës, gazit dhe ujit**

#### **Rezultatet e të nxënit në njohuri**

1. Të argumentojë rëndësinë e zbatimit të standardeve dhe legjislacionit në fuqi për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik, mbrojtjes në punë dhe mbrojtjes së mjedisit;
2. Të argumentojë rëndësinë e përdorimit të manualeve të mjeteve dhe pajisjeve të punës;
3. Të identifikojë mënyrën dhe mjetet përkatëse për dhënien e ndihmës së parë në rast aksidenti;
4. Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit periodik dhe mirëmbajtjes teknike të valvulave të sigurisë, tubacioneve, separatorëve dhe aksesoreve të sigurisë teknike;
5. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit dhe mbikëqyrjes së sinjalistikës së sigurisë në mjediset dhe ambientet e punës;
6. Të argumentojë rëndësinë e zbatimit të procedurave të evakuimit për raste emergjence;
7. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të kutisë së MZSH (*Mjeteve për Zjarrfikje dhe Shpëtim*);

8. Të shpjegojë rëndësinë e mbikëqyrjes dhe zbatimit të rregulloreve përkatëse gjatë përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimike;
9. Të shpjegojë masat në rast të mosfunksionimit të mjeteve dhe pajisjeve të sigurisë dhe shmangien e rreziqeve prej tyre;
10. Të argumentojë rëndësinë e mbikëqyrjes së përdorimit të sigurt të mjeteve dhe pajisjeve me rrezikshmëri;
11. Të argumentojë rëndësinë e mbikëqyrjes së procesit të ndarjes dhe depozitimit të mbetjeve;
12. Të argumentojë rëndësinë e mbikëqyrjes së menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme;
13. Të argumentojë rëndësinë e mbikëqyrjes së magazinimit të mbetjeve;
14. Të argumentojë rëndësinë e zbatimit të protokolleve në raste të gjendjes së jashtëzakonshme.

### **Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale**

1. Të mbikëqyrë zbatimin e standardeve dhe legjislacionit në fuqi për rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë;
2. Të mbikëqyrë zbatimin e rregullave për mbrojtjen e mjedisit;
3. Të mbikëqyrë menaxhimin e mbetjeve;
4. Të mbikëqyrë/zbatojë përdorimin në mënyrë racionale të energjisë dhe materialeve.

### **Kriteret e vlerësimit**

- Mbikëqyr vazhdimisht zbatimin e manualeve të përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- Zbaton me korrektësi legjislacionin në fuqi për sigurimin teknik
- Mbikëqyr zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit;
- Mbikëqyr zbatimin e rregullave të sigurisë gjatë punës në tension dhe lartësi;
- Mbikëqyr kontrollin periodik të valvulave të sigurisë, tubacioneve dhe separatorëve, sipas procedurës;
- Mbikëqyr marrjen e masave paraprake për parandalimin e avarive;
- Mbikëqyr zbatimin e sinjalistikës në mjediset e punës, sipas rregulloreve;
- Zbaton planin e evakuimit në raste emergjence, sipas procedurës respektive.
- Mbikëqyr zbatimin e rregullave të sigurisë dhe mbrojtjes kundër zjarrit në vendin e punës;
- Mbikëqyr zbatimin e rregullave përkatëse të përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimike, sipas specifikave;
- Mbikëqyr/merr masa në kohën e duhur në rast mosfunksionimi të mjeteve dhe pajisjeve të sigurisë;
- Komunikon me personat përgjegjës për mosfunksionimin e mjeteve dhe pajisjeve të sigurisë;
- Mbikëqyr dhënien e ndihmës së parë në rast aksidenti;
- Mbikëqyr zbatimin e procedurave për ndarjen e mbetjeve, sipas llojit;
- Mbikëqyr depozitimin e mbetjeve, sipas rregulloreve përkatëse;
- Mbikëqyr procesin e menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme, sipas rregulloreve përkatës;
- Mbikëqyr procesin e ruajtjes dhe magazinimit të mbetjeve;
- Zbaton parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;

- Përdor në mënyrë racionale energjinë dhe materialet;
- Kontrollon rrethimin e objekteve dhe tabelat e sigurisë;
- Zbaton protokollet e duhura në raste të gjendjes së jashtëzakonshme.

#### Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:

Nr.	Njësi të nxëni	Peshat në %	Kodet
1	Planifikimi, organizimi dhe koordinimi i punës në kërkim, shpim dhe shfrytëzim për naftë, gaz dhe ujë	23	NjN-21-IV-0389-25
2	Mbikëqyrja e proceseve teknologjike (shpimit dhe shfrytëzimit të puseve të naftës, gazit dhe ujit)	28	NjN-21-IV-0390-25
3	Mbikëqyrja e cilësisë së punimeve	10	NjN-21-IV-0391-25
4	Sipërmarrje dhe edukim karriere	10	NjN-23-IV-0005-24
5	Komunikimi dhe etika profesionale	9	NjN-22-IV-0006-24
6	Mbikëqyrja e rregullave të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit në kërkim, shpim dhe shfrytëzim të puseve të naftës, gazit dhe ujit	20	NjN-21-IV-0392-25
		100 %	

#### Modalitetet e vlerësimit

Me vlerësim kuptojmë procesin gjatë të cilit mblidhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së një rezultati të nxëni (RN), mbi bazën e kriterëve të caktuar.

Për vlerësimin mund të përdoren një shumëllojshmëri metodash standarde dhe inovatore.

Individi i nënshtrohet vlerësimit të vazhduar, përmbledhës dhe vlerësimit përfundimtar për kualifikimet formale që ofrohen në ofrues të akredituar.

Individi vlerësohet për shkallën e përvetësimit të kompetencave të përgjithshme dhe profesionale, të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën përkatëse dhe vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së RN për realizimin e tërësisë së proceseve duke mbajtur evidenca për qëllime dokumentimi.

Realizimi i pranueshëm do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të specifikuar.

Dhënia e rezultatit të vlerësimit bëhet sipas kuadrit ligjor në fuqi.  
Kompetencat e përgjithshme vlerësohen të integruara si pjesë e vlerësimit të njësive të të nxënit.  
Individit i lind e drejta të certifikohet për njësitë të nxëni specifike, si një kualifikim i pjesshëm sipas kuadrit ligjor në fuqi.

### **Informacion shtesë**

Kualifikimet e plota ose të pjesshme profesionale mund të përftohen nëpërmjet këtyre formave:

- a) ndjekjes së arsimit profesional me bazë shkollën;
- b) ndjekjes së kurseve profesionale, ku përfshihen edhe praktikatat profesionale në ndërmarrje apo forma të tjera të mësimnxënies praktike;
- c) regjistrimit si nxënës, duke u punësuar në një ndërmarrje (forma e dyfishtë);
- ç) njohjes të të nxënit të mëparshëm informal dhe joformal;
- d) njohjes të të nxënit të përfutur jashtë vendit;
- dh) formave të tjera të përcaktuara me ligj.

### **SHËNIM**

Shpjegime të kodit të kualifikimit: **X-IV-25**

**X** - Shkronja që identifikon fushën e kualifikimit profesional

**IV** - Shifra që identifikon nivelin sipas KSHK-së

**25** - Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar kualifikimi profesional

Shpjegime të kodit të njësisë së të nxënit: **NjN-21-IV-0389-25**

**NjN** - Shkronjat që tregojnë se kodi i referohet Njësive të të Nxënit

**21** - Numri që identifikon fushën e Njësisë së të Nxënit

**IV** - Shifra që tregon nivelin e Njësisë së të Nxënit në strukturën e KSHK-së

**0389** - Numri rritës progresiv që tregon gjendjen e Njësive të të Nxënit në ditën e hartimit përkatës

**25** - Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar Njësia e të Nxënit